



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 376/6 Prot

Urë Vajguore, 27 09 /2023

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Dimal

Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Dimal

Për dijeni:

*Kryetares së Bashkisë
Znj. Juliana Memaj*

Në mbështetje të Nenit 53 pika 4 “Funksionimi i këshillit bashkiak” të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak Dimal, **ju njoftojmë se:**

Ditën e mërkurë , më datë 27.09.2023, ora 14:00, në Njësinë Administrative Poshnje, kati i I-rë, salla e mbledhjeve, do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, me rend dite si më poshtë:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
3. Mbi miratimin e projekt-vendimit: “Miratimi i ndihmës ekonomike, nga fondi i kushtëzuar 6%, për 3 familje, me fond prej 27.918 lekë, për muajin Gusht 2023, sipas listës bashkëlidhur Drejtoria e Shërbimit Social, Ndihmës Ekonomike dhe PAK.
4. Mbi miratimin e projekt-vendimit: “Trajtimin me ndihmë ekonomike, sipas listës emërore bashkëlidhur, për 105 familje, nga fondi i Bashkisë , në shumën 244.000 lekë, për muajin Gusht 2023”. - Drejtoria e Shërbimit Social, Ndihmës Ekonomike dhe PAK.
5. Mbi miratimin e projekt-vendimit: “ Për miratimin e vlerës së mbikëqyrjes për disa objekte dhe burimi i mbulimit për vitin 2023”. – Drejtoria e Planifikimit Të Territorit.
6. Mbi miratimin e projekt – vendimit : “ Për zgjerimin e varrezave në fshatin Poshnje”. – Drejtoria e Planifikimit Të Territorit.

7. Mbi miratimin e projekt-vendimit : “ Mbi miratimin e prishjes (mbylljes) së shoqërisë aksionare “FK OSUMI” SH.A.” – Sektori i Arsimit Kulturës dhe Sporteve.
8. Mbi miratimin e projekt-vendimit : “ Për miratimin e vlerës e qirasë së ambienteve private, të cilat do të funksionojnë si kopësht/shkollë për tu përdorur për nevoja të Bashkisë Dimal” – Sektori i Arsimit Kulturës dhe Sporteve.
9. Informacion mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën 8 mujore Janar 2023 -31 Gusht 2023. – Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës.
10. Informacion mbi Raportin e Performancës 2022 për Qytetarin.
11. Informacion i përgjithshëm mbi ndryshimet klimatike në bashkinë Dimal. Drejtoria e Asistencës së Fermerit Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar.
12. Të Ndryshme.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK DIMAL
AVDULLA SALILLARI**

